

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6314  
E martë, 18 maj 2021  
çmimi 0.40

FSK-ja po fuqizon  
kapacitetet operacionale  
taktike | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE



KAPEN 400 KILOGRAMË  
KOKAINË NË KOSOVË F. 9

OPOZITA KRITIKON PROGRAMIN  
QEVERISËS, THOTË SE ËSHTË  
SIPËRFAQËSOR DHE PA MBULESË F. 5

FILLOJNË AKTIVITETET E  
SHËNIMIT TË JAVËS SË GJASHTË  
GLOBALE PËR SIGURI NË RRUGË F. 5

LEGALIZIMI I NGADALTË  
I NDËRTIMEVE PA LEJE F. 7

GRESA CAKA-NIMANI ZGJIDHET  
KRYETARE E RE E GJYKATËS  
KUSHTETUESE F. 7



## EKONOMI

KEDS-I KA INVESTUAR MBI  
28 MILIONË EURO NË RRJETIN  
NËNTOKËSOR F. 9



## SHTETI TË JETË DINJITIZOZ ME TË AKUZUARIT NË HAGË

Publicisti Muhamet Mavraj, në një intervistë dhënë në programin e mëngjesit "Sytë 7" në "Klan Kosova", ka folur për zhvillimet politike në Kosovë, për qeverisjen e Albin Kurtit, për dialogun Kosovë - Serbi dhe për Gjykatën Speciale. Ai ka thënë se kjo qeveri në Kosovë duhet të ketë kujdes nga egolatria (adhurimi i vetvetes) dhe nga egoizmi. Mavraj ka thënë se qytetarët

presin rezultate konkrete. Gjithashtu, ai ka thënë se kjo qeveri nuk e ka nisur punën mirë. Sa i përket dialogut Kosovë - Serbi, ai ka theksuar se ky proces është patatja më e nxehtë e gjithë Ballkanit, ndërsa sa iu përket të akuzuarve në Speciale, ish-udhëheqësve të UÇK-së, Mavraj ka thënë se kjo qeveri për këtë çështje duhet të silltet në nivelin e pjekurisë shtetërore

NË BËRDO TË SLOVENISË KA PËRFUNDUAR TË HËNËN SAMITI I SHEFAVE  
I SHTETEVE TË RAJONIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR | FAQE 4-5

## OSMANI: KRIMET E KRYERA NË KOSOVË NGA REGJIMI I MILLOSHEVIQIT JANË GJENOCID

Në samitin e liderëve të Ballkanit Perëndimor, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se pa pranimin e të vërtetës rajoni nuk mund të ecë përpara. Në Bërdo të Sllovenisë, Osmani ka thënë se krimet e kryera në Kosovë gjatë luftës përbëjnë gjenocid. "Krimet e kryera nga regjimi i Millosheviqit t'i quajmë me emrin e tyre të vërtetë: Krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Dhe, më e rëndësishmja është të kërkojmë nga fqinja jonë veriore, Serbia, t'i sjellë para drejtësisë autorët e këtyre krimeve të tmerrshme kundër civilëve të pafajshëm", ka deklaruar presidentja Osmani



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Për 24 orë një i vdekur dhe 25 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë

testuar gjithsej 2 333 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultojnë 25 raste pozitive.

Brenda 24 orëve është raportuar një rast i të vdekurit,

i moshës 65 vjeç, si pasojë e këtij virusi. Rasti është nga komuna e Istogut.

Numri total i rasteve pozitive është 106 939 raste nga 571 317 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 2 226 raste të të vdekurve.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 196 pacientë derisa

numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 99 824 raste, kurse numri i rasteve aktive është 4 889.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 5 raste, Gjakovë 4 raste, Gjiilan 4 raste, Klinë 2 raste, Leposaviq 2 raste, Obiliq 2 raste, Pejë 2 raste dhe



me nga një rast komunat Ferizaj, Lipjan, Podujevë dhe Viti.

## Izraeli vazhdon sulmet ajrore në Gaza

Ushtria izraelite ka ndërmarrë një valë sulmesh ajrore mëtuesin e së hënës në Rripin e Gazës, ndërsa ka bërë me dije se ka shkatërruar 15 kilometra tunele të militantëve dhe shtëpitë e pretenduara të nëntë komandantëve të Hamasit

JERUSALEM, 17 MAJ (ER) - Izraeli ka vazhduar edhe të hënën në mëtues fushatën e sulmeve ajrore në qytetin e Gazës pavarësisht prej thirrjeve për t'i dhënë fund luftës.

Aeroplanët luftarakë izraelitë ndërmoren 80 sulme ajrore në disa zona të qytetit të Gazës, menjëherë pasi militantët e Hamasit hapën një breshëri raketash në Izraelin jugor.

Nga sulmet ajrore izraelite janë vrarë më shumë se 40 njerëz, thanë zyrtarët shëndetësorë që kontrollohen nga Hamasi.

Përmes një deklaratë, Forca e

Mbrojtjes e Izraelit (IDF) ka njoftuar se "avionët luftarakë po godasin objektivat e terroristëve në Rripin e Gazës". Ushtria ka njoftuar se ka shkatërruar 15 kilometra tunele të militantëve si dhe shtëpitë e nëntë komandantëve të pretenduar të Hamasit.

Një ndërtesë trekatëshe në Gaza është dëmtuar rëndë, por banorët thanë se ushtria izraelite i paralajmëroi ata 10 minuta para sulmit, dhe të gjithë u evakuuan. Sulmet e fundit ajrore kanë shkaktuar ndërprerje të energjisë dhe



kanë dëmtuar qindra ndërtesa. Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se sulmet do të vazhdojnë me "forcë të plotë" dhe do të "marrin kohë".

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, i ka kërkuar Papa Françeskut të ndihmojë

në mobilizimin e botës për të miratuar sanksione kundër Izraelit për "masakrën" e tij ndaj palestinezëve në Rripin e Gazës.

Turqia ka shtuar angazhimin diplomatik për situatën në Gaza dhe telefonata midis Erdoganit dhe Papa Françeskut

u zhvillua në këtë vijë.

Erdogani i tha Papa Françeskut se "palestinezët do të vazhdojnë t'i nënshtrohen një masakre nëse bashkësia ndërkombëtare nuk e dënon Izraelin me sanksione", ka njoftuar presidenca turke.

Sipas Turqisë, mesazhet e Papës janë të një rëndësie të veçantë për ta "mobilizuar botën e krishterë dhe bashkësinë ndërkombëtare".

Të dielën Papa Françesku tha se humbja e jetëve të pafajshme në Gaza ishte "e tmerrshme dhe e papranueshme".

Erdogan, i cili ka mbështetur çështjen palestineze gjatë qeverisjes së tij 18-vjeçare, ka folur vazhdimisht kundër veprimeve të Izraelit. Ai i tha Papës se "i gjithë njerëzimi duhet të jetë i bashkuar kundër" Izraelit.

## Blinken viziton Danimarkën, diskuton për ekonominë, sigurinë dhe klimën

KOPENHAGË, 17 MAJ - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, është takuar të hënën në Kopenhagë me kryeministren daneze Mette Frederiksen. Bisedimet u përqendruan në çështje ekonomike, ato që lidhen me sigurinë dhe klimën, si dhe nxitjen e vazhdueshme që administrata Biden po ua bënë përpjekjeve për t'i forcuar lidhjet me aleatët e Shteteve të Bashkuara. "Ne presim një



thellim të partneritetit tonë mbi qëllime të ndërsjella, që përfshijnë përballjen me krizën që shkaktojnë ndryshimet klimatike, rritjen e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, garantimin e sigurisë në fushën e energjisë si dhe partneritetin në kuadër të vendeve të Arktikut", ka thënë Blinken pas takimit me Frederiksen.

Diplomati i lartë amerikan ka zhvilluar një takim edhe me

Mbretëreshën Margrethe II.

Para se të nisej nga Uashingtoni, Blinken ka thënë se Kopenhaga do të jetë "ndalesa e parë në një udhëtim që do të përqendrohet në forcimin e NATO-s, partneritetit në kuadër të vendeve të Arktikut, përballjen me krizën e klimës si dhe sfidat e tjera globale".

Pas Danimarkës, Blinken do të shkojë në Rejkjavik të Islandës, ku do të marrë pjesë në takimin ministror të Këshillit të Arktikut.

## PD-ja mban zgjedhjet për kryetarin e ri më 13 qershor

TIRANË, 17 MAJ - Partia Demokratike (PD) në Shqipëri ka vendosur ta hapë garën për kryetarin e ri të saj në zgjedhjet e brendshme që do të mbahen më 13 qershor të këtij viti. PD-ja do të shkojë në zgjedhje të parakohshme, të cilat ishin planifikuar që të mbahen në muajin korrik, pas një mbledhjeje të mbajtur të dielën në mbrëmje pa

praninë e mediave, ku disa prej anëtarëve të partisë kërkuan dorëheqjen e kryetarit aktual, Lulzim Basha, duke thënë se ai është fajtor për humbjen e PD-së në zgjedhje e 25 prillit.

Basha edhe në mbledhjen e kryesisë thuhet ta ketë ripërsëritur qëndrimin e tij se zgjedhjet e 25 prillit kanë qenë një "masakër elektorale",

duke hequr përgjegjësitë e tij për rezultatin e zgjedhjeve.

Bëhet me dije se Basha do të rikandidojë për kryetar të partisë.

Nga një anë qëndron një grup i kundërshtarëve, përfshirë ish-presidentin Bujar Nishani, kryetarin e Këshillit Kombëtar të PD-së, Fatbardh Kandilli, të cilët i kërkojnë kryetarit Lulzim Basha të japë



dorëheqje duke thënë se ai duhet të marrë përgjegjësi për humbjen e zgjedhjeve të përgjithshme. Nga ana tjetër

qëndrojnë përkrahësit e Bashës, të cilët pretendojnë për manipulim të zgjedhjeve, por edhe thonë se Partia Demokratike u rrit nën drejtimin e Bashës.

Në zgjedhjet e 25 prillit demokratët arritën të merrnin 59 mandate në Kuvendin e Shqipërisë krahasuar me 46 që kanë pasur në 2017-n.





# Shteti të jetë dinjitoz me të akuzuarit në Hagë

Publicisti Muhamet Mavraj, në një intervistë dhënë në programin e mëngjesit “Syte 7” në “Klan Kosova”, ka folur për zhvillimet politike në Kosovë, për qeverisjen e Albin Kurtit, për dialogun Kosovë - Serbi dhe për Gjykatën Speciale. Ai ka thënë se kjo qeveri në Kosovë duhet të ketë kujdes nga egolatria (adhurimi i vetvetes) dhe nga egoizmi. Mavraj ka thënë se qytetarët presin rezultate konkrete. Gjithashtu, ai ka thënë se kjo qeveri nuk e ka nisur punën mirë. Sa i përket dialogut Kosovë - Serbi, ai ka theksuar se ky proces është patatja më e nxehtë e gjithë Ballkanit, ndërsa sa iu përket të akuzuarve në Speciale, ish-udhëheqësve të UÇK-së, Mavraj ka thënë se kjo qeveri për këtë çështje duhet të sillet në nivelin e pjekurisë shtetërore

**Prishtinë, 17 maj -**  
*Po e nisim këtë bisedë me një fjali tuajën publikuar në rrjetin social Facebook: “Gjithkush ka një kohë, Kosova ka kohën e vet”. Çfarë po ndodh me kohën e Kosovës dhe a po e humb Kosova hapin e saj?*  
**Mavraj:** Kjo është thënie që e kam pasur në një postim timin personal. Është folur për kohën e kombit, kohën e Kosovës, dhe jo kohën e ndonjë personi apo grupi njerëzish. Mendoj se është kohë kritike, shumë e rëndësishme që të shfrytëzohet maksimalisht. T’u jepet një përfundim bisedimeve Kosovë - Serbi në atë mënyrë që kompozicioni i tanishëm ndërkombëtar, në pjesën

evropiane i pafavorshëm dhe në pjesën amerikane ekstremisht i favorshëm për Kosovën, të shfrytëzohet sa më mirë që është e mundur. Kur e kam shkruar këtë postim e kam pasur parasysh edhe mandatin e Bidenit, por e kam parasysh se në katër vjetët e ardhshme bëhet çereku i shekullit të çlirimit të Kosovës dhe një çështje që zvarritet shumë gjatë, ka mundësi të shkojë atje ku po dëshiron Serbia: ta bëjë të ashtuquajturin konflikt të ngrirë, i cili, me kalimin e kohës, palestinizohet në kuptimin e trajtimit si temë. Kjo nuk më pëlqen, prandaj jam për një dinamizim të jetës politike në Kosovë dhe dinamizim të

procesit sa i përket Kosovës. Ajo që për mua është e logjikshme dhe më trishton, është fakti se izolimi i Kosovës nuk vjen nga brenda, por nga jashtë. Dhe, për fatin tonë të keq, lidhet shumë me dialogun e kushtëzuar evropian Kosovë - Serbi, për shkak se të priturat kryesore për dalje nga ky izolim janë nga Bashkimi Evropian dhe pikërisht nga BE-ja kemi obstrukcione të çuditshme, qoftë me njohjen e Kosovës, e cila do të mund të bëhej dhe nuk po bëhet dhe askush nuk po ushtron presion ndaj pesë shteteve jonjohëse të BE-së, qoftë me fjala, për një çështje ekstremisht banale siç është çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën. Ky

liberalizim Evropës nuk i kushton asgjë dhe nuk ka kurrfarë rreziku nga liberalizimi i vizave për Kosovën, aq më pak kur vetë institucionet e BE-së, moti, ka katër-pesë vjet që i kanë dhënë “vizën” Kosovës dhe kanë dëshmuar se Kosova i ka përmbushur kriteret për liberalizim të vizave. Ndërkohë, tash shfaqet niveli ndërqeveritar i BE-së, ku Franca, Holanda dhe një shtet tjetër, dalin si shtete që janë diçka mbi BE-në.

*Nga çfarë duhet të ketë sot kujdes politika e Kosovës?*

**Mavraj:** Duhet të ketë kujdes nga egolatria (adhurimi i vetvetes) dhe nga egoizmi. Duhet të ketë shumë kujdes nga vetëkënaqësia. Duhet të ketë kujdes nga përqindjet e larta të sondazheve të cilat nuk të shpjen askund. Njerëzit kërkojnë rezultate konkrete, e kur rezultatet konkrete fillojnë të mungojnë, sidomos kur fillon të zhduket në horizont perspektiva që njerëzit e kanë imagjinuar, një revoltë qytetare do të ishte e pashmangshme. Kam shumë frikë se rinia do të na ikë sërish jashtë sikurse që kishim disa valë të mëhershme të ikjes, atëherë pak nga zhgënjimi e pak nga propaganda shumë

negative e madhe kundër Kosovës, pra nga vetë Kosova, e kështu me radhë.

*Po lidhem sërish tek thënia jote në Facebook: “ai stan bylmet ka”. Çfarë ke dashur të thuash?*

**Mavraj:** Është fjalë popullore dhe kam dashur të them se askush nuk mund të dalë jashtë vetvetes dhe nuk mund t’i kërkosh askujt atë që është e panatyrshme në karakterin e tij. Kjo ishte në një kontekst vendor këtu te përkujtimi i dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku flitet gjithçka dhe shmanget me çdo kusht akronimi UÇK-së, thua ti se është turp për ta përmendur UÇK-në dhe shmanget gjithçka që eventualisht, në ato horizontet mendore të elitës politike, këtu mund t’i shpie ndonjë lloj favorizimi njerëzve që e kanë çliruar Kosovën ose njerëzve që, për shkak se e kanë çliruar Kosovën kanë kaluar ose po kalojnë jetën në burgje. Do të thotë një lloj shpirtngushtësie, prandaj u kam thënë njerëzve që mos të hidhërohen se, në fund të fundit, edhe për ta përmendur kur nuk e duan ose nuk e kanë dashur asnjëherë UÇK-në, e përmendin fals. Pra, më mirë hiq sesa fals. Unë për veten time, sa

herë që disa njerëz të tillë nuk e përmendin UÇK-në, që e di që nuk e kanë dashur kurrë, u jam shumë mirënjohës.

*Tashmë në Hagë kemi njerëzit kryesorë të UÇK-së. Çfarë po bën sot shteti i Kosovës për ta?*

**Mavraj:** Nëse të kujtohet në një bisedë që kemi pasur para rreth një viti kemi pas thënë se në të ardhmen Kosova do të ballafaqohet me dy tema: pandeminë dhe Gjykatën Speciale. Ky shtet aktualisht që është kryen minimalisht disa nga funksionet ligjore. Ushtron disa prej të drejtave që ligji ua jep të akuzuarve në Hagë, por asgjë më shumë, dhe nuk pritet shumë nga ky stabilizim që të bëjë për ta. As unë nuk pres që vetë ata, të akuzuarit, të kërkojnë ndonjë lloj favorit nga këta, po supozoj, se nuk kam ndonjë informacion, por në bazë të njohjes, karakterit dhe dinjitetit të tyre që ua njoh, nuk pres nga ata personalisht që të kërkojnë personalisht nga dikush në Kosovë diçka. Shkuarja e tyre në Hagë ka qenë shumë dinjitoze dhe mua më ka bërë shumë përshtypje apeli i Thaçit që askush të mos protestojë kundër Gjykatës Speciale dhe askush të mos dalë në rrugë që të përkrahë Thaçin ose të arrestuarit e tjerë të

UÇK-së, që i bie se Kosoven e liron nga barra që e merr përsipër vetë. Kjo ka qenë për t'u vlerësuar dhe mbi këtë bazë po them as që do të kërkojnë, por shtetit i ka hije ta tregojë veten si shtet: për hir të qytetarëve të Kosovës dhe për hir të dinjitetit shtetëror, por edhe për shkak se e obligon ligji. Ka pasur shumë debate këtu se ofroi ose nuk ofroi garanci qeveria. Nuk ofrohen garancitë pa i kërkuar vetë gjykata, avokatët ose vetë të akuzuarit.

*A vazhdon të mbajë inati zoti Kurti me Thaçin?*

**Mavraj:** Mbase mund të mbajë inate, por tani është burrështetas dhe duhet të silltet me pjekuri të burrështetasit. Tani është kryeministër edhe i atij që është në burg, edhe i atyre që janë ose mund të burgosen, edhe i këtyre që nuk janë të akuzuar, edhe i atyre që e kanë votuar dhe atyre që nuk e kanë votuar ose edhe i tyre që nuk e kanë ndërmend ta votojnë. Patjetër që duhet të silltet në nivelin e pjekurisë shtetërore.

*Kur jemi te zoti Kurti, kemi një fotografi të vitit '97. Shihet zoti Kurti në foltore, ju jeni pas. Çfarë personifikon kjo fotografi për ju sot?*

**Mavraj:** Kjo fotografi është

protesta e dytë e jona më 29 tetor. Këtu zotëri Kurti po lexon version anglisht të fjalimit tonë. Një version e ka lexuar Remzije Shahini dhe një tjetër Bujar Dugolli. Kjo protestë kështu është mbajtur. Kanë qenë fjalime të Unionit të Studentëve, ku kemi shfaqur pikëpamjet tona dhe protesta ka përfunduar aty, pra është mbajtur në Velani. Nuk kemi udhëtuar atë ditë sikurse më 1 tetor kur ishte ajo ndërhyrja brutale. Këtu është duke lexuar version anglisht të fjalimit tonë ku, ndër të tjera, përmendet edhe çështja e të drejtave të Kosovës. Pra, kemi dalë gjithmonë ngapak përtej kornizave studentore, të atij organizimi gjoja apolitik.

*Sa ka ndryshuar zoti Kurti prej kësaj fotografie?*

**Mavraj:** Ka ndryshuar Kurti, kanë ndryshuar të gjithë ngapak. Është normale që të gjithë ngapak të ndryshojnë. Kisha dashur që kjo qeveri ta bartë atë frymën që kemi pasur në vitin 1997.

*Po e mban?*

**Mavraj:** Jo, është tërësisht partiake. Fryma jonë ka qenë gjithëpërfshirëse në atë kohë. Kemi bërë çmos që t'i marrim të gjithë me vete, jo me dhunë, por me dëshirë. Gjashtë-shtatë javë u kemi shpjeguar të gjithëve

pikëpamjet tona. Nuk kemi lënë asnjë paqartësi deri tek organizimi më i imtë i 1 tetorit dhe këtyre organizimeve të tjera që kemi pasur te Lidhja Demokratike, te Partia Parlamentare, te socialdemokratët, te liberalët, te burgosurit politikë, te Shoqata e Shkrimtarëve, te studentët, pra të të gjitha grupet në shtatë qendrat e Kosovës në atë kohë, vetëm që të dalim sa më unikë dhe më gjithëpërfshirës, që ta paraqesim Kosovën dhe jo emrat tanë.

*Sot sa i besoni zotit Kurti?*

**Mavraj:** Po tani ai është politikan. Ai tani i ka agjendat e veta dhe kalkulimet e veta. Në pikëpamjen e besimit mund të flasim varësisht nga fusha që e shtrijmë.

*Flas për qeverisjen e tij. E ka nisur punën mirë?*

**Mavraj:** Jo, nuk e ka nisur punën mirë. Është shumë flegmatik. Pak më dinamike ishte ajo qeveria me LDK-në që e rrëzuan për kurrjë. Tani është disi shumë i ngadalshëm dhe shumë i plogësht. Sot në Kuvend do të diskutohet programi i qeverisë, pra të shkojnë dy muaj ne qeverisje dhe tek sot të diskutohet kjo temë, programi. Ky është ai rreziku, koha e

Kosovës që po zvarritet dhe që po humb. Unë gjithmonë ndiej trishtim kur shoh në këtë fazë çfarëdo arsye për zvarritje ose për ndryshime të qeverive. Nuk më kanë pëlqyer këto. Herën e kaluar para një viti e kemi përmendur në këtë studio 10 qershorin 2014. Që nga ajo ditë, dhe pak më përpara do vite i kemi çuar kot, që nga 10 qershori 2014 shumë-shumë pa nevojë kemi zvarritur kohën e Kosovës. Kanë mjaftuar dy qeveri prej atëherë deri më tani, ndërsa i kemi 6-7 qeveri nga ajo kohë. Ne nuk e kemi këtë luks për kaq shumë qeveri.

*Si e sheh dialogun Kosovë - Serbi me qeverinë Kurti?*

**Mavraj:** Do të ballafaqohet me këtë temë. Është patatja më e nxehtë e gjithë Ballkanit, pra edhe e Kosovës. Shpresoj shumë që në momentin vendimtar do ta gjejë trimërinë për të nënshkruar një marrëveshje që Kosovës i siguron njohjen de jure, e përseris: vetëm njohjen e llojit de jure nga Serbia, dhe pa pengesë anëtarësimi në Kombet e Bashkuara. Kjo qeveri ose ata që flasin në emër të saj, duhet të kenë kujdes me deklaratat e panevojshme ndaj cilitdo shtet që në të ardhmen mund të na godasë me veto, ose të shteteve që inspirojnë veton kundër Kosovës në Këshillin e Sigurimit. E di që nuk është afër ajo ditë, por edhe e di se nuk është e pamundshme.

*A ishte korrekt reagimi i qeverisë në konfliktin Izrael - Palestinë? A ishte i vonuar?*

**Mavraj:** Sigurisht që ka qenë i vonuar, por tani se a ka bërë mirë a jo me përmbajtjen, këtu mund të hapen shumë tema.

*A duhet Kosova të implikohet në këtë konflikt?*

**Mavraj:** Patjetër. Kosova ka nënshkruar në Uashington një marrëveshje dhe në të parashihet shpallja e terroriste e organizatës Hamas, e cila është shkaktare e konfliktit. Dhe nuk mendoj fare se Hamasi është duke i mbrojtur interesat e Palestinës. Interesat mbrohen me matjen e rezultateve konkrete dhe jo me numërimin e kufomave të fëmijëve. Rezultatet e Hamasit janë rregullisht provokime të atilla që e detyrojnë Izraelin të bombardojë pa mëshirë. Më vjen shumë keq kur shoh viktimat e palestinezëve dhe të izraelitëve, sepse edhe në anën e tyre ka të vrarë, por Kosova është shumë e vogël për të hyrë në ujërat e turbullta të Palestinës, të Rusisë dhe të Serbisë, por është shumë e vogël edhe për t'iu shmangur detyrimeve që tashmë i ka marrë për shpalljen e Hamasit si organizatë terroriste.

(Intervistoi gazetari Florent S. Zeqaj, TV "Klan Kosova")





Në Bërdo të Sllovenisë ka përfunduar të hënën samiti i shefave i shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor

# Osmani: Krimet e kryera në Kosovë nga regjimi i Millosheviqit janë gjenocid

Në samitin e liderëve të Ballkanit Perëndimor, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se pa pranimin e të vërtetës rajoni nuk mund të ecë përpara. Në Bërdo të Sllovenisë, Osmani ka thënë se krimet e kryera në Kosovë gjatë luftës përbëjnë gjenocid. “Krimet e kryera nga regjimi i Millosheviqit t’i quajmë me emrin e tyre të vërtetë: Krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Dhe, më e rëndësishmja është të kërkojmë nga fqinja jonë veriore, Serbia, t’i sjellë para drejtësisë autorët e këtyre krimeve të tmerrshme kundër civilëve të pafajshëm”, ka deklaruar presidentja Osmani

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 MAJ- Në Bërdo të Sllovenisë ka përfunduar samiti i shefave i shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, i cili është mbajtur në kuadër të nismës së përbashkët të Sllovenisë dhe Kroacisë në Bërdo Brion. Kjo nismë ka për qëllim t’ ndihmojë vendet e rajonit në procesin e integriteteve evropiane.

Në fjalën e saj në samitin e presidentëve të rajonit në Bërdo, presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, duke folur për perspektivën e BE-së dhe të marrëdhënieve fqinjësore në rajon, ka theksuar se nuk mund të kalohet në kapitujt vijues përpara se të lexohen dhe kuptohen plotësisht kapitujt e mëparshëm. Osmani ka theksuar se është i nevojshëm pranimi i së vërtetës për atë që ka ndodhur në rajon. “Kur flasim për atë se çfarë ndodhi në të vërtetë me viktimat, të

mbijetuarit, të zhdukurit nga luftërat. Dhe më e rëndësishmja, kur flasim mbi atë se pse nuk janë prapa hekurave autorët e këtyre krimeve të neveritshme të kryera nga regjimi i Millosheviqit. Përtej detyrës sime si presidente e qytetarëve të Republikës së Kosovës është detyrë morale dhe njerëzore e imja të flas të vërtetën mbi atë se çfarë ka ndodhur në vendin tonë. Krimet e kryera nga regjimi i Millosheviqit t’i quajmë me emrin e tyre të vërtetë: Krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Dhe, më e rëndësishmja është të kërkojmë nga fqinji ynë verior, Serbia, t’i sjellë para drejtësisë autorët e këtyre krimeve të tmerrshme kundër civilëve të pafajshëm”, ka potencuar presidentja Osmani.

Sipas Osmanit, në vend të përgjegjësisë po ndodh mohimi dhe revizionizmi historik i asaj që ndodhi gjatë viteve ’90 në rajon. “Leadershipi i

përgjegjshëm dhe i guximshëm kërkon refuzim të vendosur të një veprimi të tillë të ndyrë”, ka theksuar presidentja Osmani. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është larguar para përfundimit të samitit, me arsyetimin se ka takime në selinë e NATO-s në Bruksel. Ai citohej t’u ketë thënë gazetarëve serbë se nuk ka pranuar që në konkluzat e takimit të përmendet mosndryshimi i kufijve në rajon, pa u përfshirë edhe kërkesa e Serbisë që kjo të nënkuptojë “mosndryshimin e kufijve të njohur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara” që, sipas tij, nuk është pranuar nga presidentja e Kosovës.

Vuçiqi ka insistuar se Kosova është “pjesë e Serbisë” dhe se “me shpalljen e pavarësisë së

Kosovës, po ashtu, nuk është respektuar parimi i mosndryshimit të kufijve”.

Pas këtij samiti, presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, ka thënë se formulimi që kërkoj Vuçiqi, për deklaratën përfundimtare, do të nënkuptonte që disa shtete, përfshirë edhe shtetin e tij, ta tërhiqnin njohjen e Kosovës. “Presidenti Vuçiq nuk ishte kundër që të diskutohej për ndalimin e ndryshimit të kufijve kombëtarë, por ai propozoi një formulim të tillë që do t’i ndalonte të gjitha shtetet që ta njohin Kosovën sepse Kroacia e ka njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës, Sllovenia dhe disa shtete të tjera e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Jo të gjitha shtetet e BE-së e kanë njohur. Ishte e qartë se ne

mund t’i nisnim diskutimet për këtë temë, por ato nuk do të përfundonin kurrë”, ka deklaruar Pahor.

Ndërkaq presidenti kroat, Zoran Millanoviç, ka thënë se ky samit kishte për qëllim t’i ndihmojë shtetet e Ballkanit Perëndimor “që të përafrohohen me BE-në, dhe jo për të komplikuar edhe më tej gjërat”. Në takim morën pjesë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, krahas kolegëve nga shtetet e tjera të rajonit: presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, i Malit të Zi, Millo Gjokani, Stevo Pendarovskit i Maqedonisë së Veriut, Aleksandër Vuçiqi i Serbisë, ndërsa nga Bosnja e Hercegovina ishin të ftuar të tre anëtarët e presidencës kolektive të këtij shteti: Shefik Xhaferoviç, Zheljko Komshiq dhe Millorad Dodik.

## Fillojnë aktivitetet e shënimit të Javës së Gjashtë Globale për Siguri në Rrugë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 MAJ - Nën organizimin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Asociacionit Kosovar të Motorizimit dhe Policisë së Kosovës, është shënuar “Java Globale e Sigurisë Rrugore”, ku qëllim kryesor i fushatës është kufizimi i shpejtësisë për automjete deri në 30 km/h.

Zëvendësministri i MMPHI-së, Hysen Durmishi, ka shprehur bindjen e tij se renditja e sigurisë rrugore si prioritet i



lartë do të kontribuojë në uljen e numrit të aksidenteve rrugore dhe përmirësimin e gjendjes në

sigurinë e trafikut rrugor në përgjithësi. “Kufizimi në këtë shpejtësi shpëton jetë dhe

mbroton të gjithë pjesëmarrësit që i përdorin rrugët, veçanërisht fëmijët, këmbësorët, biçiklistët, njerëzit e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara, andaj duke u sjellë në pajtim me rregullat dhe ligjet e trafikut rrugor, secili nga ne mund të kontribuojë në përmirësimin e gjendjes së sigurisë në trafikun rrugor”, ka thënë Durmishi.

Ndërsa Gazmend Hoxha, përfaqësues i Policisë së Kosovës, ka thënë se policia është pjesë e këtij aktiviteti dhe do të përkrahë me njësitë relevante këtë aktivitet duke

bërë thirrje për respektimin e rregullave të trafikut. “Njëkohësisht mbështet propozimin që në vendbanimet urbane dhe pranë shkollave të ketë shpejtësi më të ulët, 30 kilometra në orë”, është shprehur Hoxha, duke shtuar se respektimi i rregullave të trafikut duhet të bëhet nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik. “Policia e Kosovës do të vazhdojë të punojë për ngritjen e nivelit të sigurisë në trafik si dhe për zvogëlimin e aksidenteve në përgjithësi”, ka deklaruar Hoxha.



KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA PARAQITUR PARA DEPUTETËVE PROGRAMIN E QEVERISË PËR VITET 2021-2025

# Opozita kritikon programin qeverisës, thotë se është sipërfaqësor dhe pa mbulesë



Kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije se programi qeverisës është reflektim i premtimeve të fushatës elektorale. Teksa ka prezantuar programin para deputetëve, ai ka thënë se programi i qeverisë është projektim i modelit të shoqërisë që duam të ndërtojmë. Mirëpo opozita e ka kritikuar këtë program, duke thënë se ai është sipërfaqësor. Liderët opozitarë kanë bërë me dije se dokumenti 60-faqësh është shkruar në mënyrë dëshirore dhe, si i tillë, nuk ka mbulesë financiare

Sipas Kurtit, programi i qeverisë është projektim i modelit të shoqërisë që duam të ndërtojmë. “Programi që keni para jush është reflektim i premtimeve jo vetëm të fushatës elektorale, por i premtimeve ndaj së ardhmes. Është më shumë se numra dhe shkronja dhe më shumë se kursime dhe shpenzime, sepse është projektim i modelit të shoqërisë që duam të ndërtojmë së bashku. Është ajo për të cilën kemi folur tashmë një kohë të gjatë. Ndërtimin e një shoqërie ku secili fiton pjesën që meriton dhe paguan detyrimin që i takon, një shoqërie ku askush nuk mbetet mbrapa dhe secili arrin ta realizojë potencialin e dhënë nga zoti a natyra”, ka thënë Kurti, duke shtuar se dëshiron të ndërtojë një shoqëri të barabartë dhe me mundësi të barabarta që kujdeset për më të dobët dhe ata që fitojnë më së paku. Para deputetëve kryeministri Kurti ka thënë se programi qeverisës parasheh rritjen e pagës minimale. Sipas tij, në Kosovë askush që punon 8 orë në ditë nuk duhet të marrë më pak se 10 euro në ditë dhe askush nuk duhet të tashë për mbijetesë. Ndër të tjera, Kurti ka thënë se qeveria do të bëjë 500 vlerësime të jashtme të shkollave për të siguruar vlerësim të drejtë dhe cilësor, do të investojë në shëndetësi, do ta reformojë sistemin shëndetësor, do të investojë në barazi, mbrojtje dhe mundësi të barabarta, do të investojë në ekonomi që hap vende të reja të punës, do ta

reformojë ekonominë, bujqësia do të marrë vëmendjen që i takon, si dhe kultura e sporti do të zhvillohen dhe mbështeten. Kurti ka folur edhe për procesin e dialogut me Serbinë, duke e ftuar opozitën për bashkëpunim. “Ne mund të mos pajtohemi për shumë çështje por le të provojmë të pajtohemi karshi politikës ndaj Serbisë. Në secilën ditë të javës e në secilën orë të ditës unë jam i gatshëm të takohem me cilindo lider të opozitës i cili nuk pajtohet me parimet e qëndrimet tona për dialogun dhe ka propozime të tjera se si ta mbrojmë më mirë interesin e Republikës. Por, mos harroni se ju që keni qenë në pushtet në këto dy dekada që lamë pas, keni bërë tashmë një trashëgimi që na ka ngjitur neve. Pjesa më e madhe e punës dhe energjisë time në dialog është në zhbërjen e dëmit që keni shkaktuar ju”, ka thënë Kurti.

## Opozita: Program pa mbulesë

Por ky program qeverisës është kritikuar nga opozita. Kryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë se qeveria ka dështuar në menaxhimin e pandemisë dhe sigurimin e vaksinave. “Sot qeveria do të duhej me nguti dhe vendosmëri të trajtonte një kryetemë tjetër: vaksinimin e qytetarëve. Pamjet e shëmtuara të trajtimit të prindërve, gjyshërve dhe të moshuarve tanë, ku ata shtyeshin me njëri-tjetrin pa fajin e tyre për të marrë

një vaksinë, tregon që vendi po lëviz drejt një katastrofe shëndetësore”, ka thënë Hoxhaj. Sipas të parit të PDK-së, programi qeverisës është një “paqavër”. “Programin që e kemi nuk ka plan veprimi, nuk ka afate kohore, nuk ka buxhet dhe është programi më i dobët e i kotë për përsëritje të përmbajtjes. Albin Kurti kishte krijuar bindjen se sapo ta udhëheqë qeverinë do ta bëjë transformimin ekonomik dhe politik në vend”, ka thënë Hoxhaj.

Në anën tjetër, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se dokumenti 60-faqësh nuk ka as argument e as ide të fjalës. “Të presësh 60 ditë e të marrësh një dokument 60 faqesh si përfundim, veç fillon të kesh dyshim mbi aftësinë e dikujt që të gjitha problemet ekonomike, politike, arsimore, shëndetësore, të rendit e ligjit, të sigurisë e integritimit, të dialogut e punësimit, të korrupsionit e nepotizmit, të kapjes e pandemisë do t’i përfshijë në 60 faqe platformë. Dyshimin disi e kapërcen sepse faqet, megjithatë, s’e bëjnë përmbajtjen”, ka thënë Abdixhiku. Sipas tij, ky planprogram është një ndër dokumentet më sipërfaqësore e më jopërmbajtësore që ka lexuar ndonjëherë. “Është një dokument që s’përmban ndonjë masë, ndonjë matje e ndonjë numër. S’përmban as kohë se kur do të nisë e kur do të përfundojë një politikë qeveritare për katër vjet planifikim. S’thotë gjë, askund, përjashtoj ndonjë politikë dytësore aty-këtu se çfarë problemi do të adresojë, çfarë rezultati do të japë, kush do ta implementojë, sa do të kushtojë e si do ta bëjë atë. Këtë pret secili nga një program qeverisës. Çfarë do të bëhet për katër vjet e si do të duket vendi ynë i përbashkët katër vjet nga sot!”, është shprehur ai.

Edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kritikuar programin qeverisës. Sipas tij, ky është një dokument ideor dhe jo një plan i mirëfilltë qeverisës. “Nuk kemi një plan të veprimeve dhe detyrave me afate kohore dhe me kosto. Si dhe çka do të ndodhë, që ta dinë qytetarët e Kosovës. Pra, çka do të bëhet me ta. Nëse e lëni si është sot, atëherë i keni lënë ministrat pa detyra. Nuk u keni dhënë një kornizë të qartë ministrave, duke u lënë hapësirë të madhe që të zgjedhin”, ka deklaruar Haradinaj.

**EPOKA  
ERE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 17 MAJ** - Subjektet politike opozitare kanë kritikuar programin qeverisës. Në seancën plenare të Kuvendit, ku kryeministri Albin Kurti ka prezantuar programin qeverisës për vitet 2021-2025, përfaqësuesit e opozitës kanë thënë se ky program është sipërfaqësor, jopërmbajtësor dhe nuk ka referencë të mbulueshmërisë financiare. Megjithatë, shefi i ekzekutivit, Albin Kurti, ka deklaruar se programi qeverisës është reflektim i premtimeve jo vetëm të fushatës elektorale, por edhe i premtimeve ndaj së ardhmes.

Ai ka lavdëruar punën e qeverisë, duke thënë se në këto 55 ditë janë bërë shumë punë. “Sot janë bërë 55 ditë nga marrja e detyrës e qeverisë tonë. Në këto 55 ditë kemi bërë shumë punë të cilat do t’i hedhin bazat drejt zhvillimit dhe progresit për katër vjetet e

ardhshëm. Siç e kemi thënë edhe në program, prioriteti më urgjent është menaxhimi i pandemisë. Me marrjen e mandatit ne kemi hartuar pa humbur kohë një plan i cili synonte që së pari ta ndalte trendin e rrezikshëm që e trashëguam të rritjes së infektimit dhe të vdekjeve, pastaj të kthenim mbrapsht këtë trend me synim eliminimin e vdekjeve si pasojë e virusit Covid-19”, ka thënë Kurti. Ai ka thënë se masat e reja anti-Covid ishin efektive dhe të suksesshme për ndalimin e përhapjes së pandemisë. “Në këto 55 ditë kemi arritur të sigurojmë 74 100 vakcina, ndërsa deri në fund të këtij muaji do të kemi edhe 142 530 vakcina të tjera që gjithsej arrijnë në 216 630 vakcina. Me këto dhe me pritjet që kemi për muajin qershor, jemi në rrugë të mirë për ta garantuar imunizimin e 60 % të popullsisë në grupmoshën e atyre që duhen vaksinuar deri në fundin e vitit 2021”, ka thënë ai.



# Legalizimi i ngadaltë i ndërtimeve pa leje

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 MAJ - Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje, sipas informatave të pranuar nga shumica e komunave në Kosovë, deri më tani ka ecur me ritëm mjaft të ngadaltë. Sikurse numri i aplikimeve, ashtu edhe numri i ndërtesave të legalizuara janë simbolike në raport me numrin e objekteve pa leje në regjistrin përkates.

"EC Ma Ndryshe" ka kërkuar informata nga 30 komuna të Kosovës lidhur me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, ku 23 prej tyre kanë ofruar të dhëna lidhur me rrjedhën e deritanishme të trajtimit të ndërtimeve pa leje.

Bazuar në të dhënat e pranuar prej 23 komunave, del se deri në mars të vitit 2021 janë pranuar gjithsej 5 758 aplikime për legalizim, prej të cilave 2

178 janë legalizuar, ndërsa 1 148 janë në listë të pritjes dhe 38 kërkesa janë refuzuar.

Komuna e Prishtinës kryeson me 2 061 aplikime për legalizim, përderisa numri i objekteve të legalizuara në këtë komunë përbën shifrën 650, pastaj vijjnë: Komuna e Prizrenit me 1 390 aplikime për legalizim dhe 248 objekte të legalizuara, Komuna e Vushtrisë me 387 aplikime për legalizim dhe 130 objekte të legalizuara, Komuna e Pejës me 346 aplikime për legalizim dhe 201 objekte të legalizuara, Komuna e Ferizajt me 302 aplikime për legalizim dhe 302 objekte të legalizuara, Komuna e Mitrovicës së Jugut me 349 aplikime për legalizim dhe 181 objekte të legalizuara, etj. Viojnë edhe komunat me shifra dukshëm më të ulëta, si Komuna e Hanit të Elezit me 10 aplikime për legalizim dhe 5 objekte të legalizuara, Komuna e Deçanit me 6 aplikime për

legalizim dhe 5 objekte të legalizuara, Komuna e Junikut me 4 aplikime për legalizim dhe 3 objekte të legalizuara, Komuna e Dragashit me 4 aplikime dhe 1 objekt të legalizuar. "Në vitin 2016, sipas regjistrimit të ndërtimeve, pa leje në Kosovë janë evidentuar 352 836 ndërtime pa leje, prej të cilave deri në atë vit janë legalizuar 8 461 sosh. Për shkak të numrit të ulët të aplikimeve dhe legalizimeve ishte miratuar ligji i ri për trajtimin e ndërtimeve pa leje, që ka hyrë në fuqi në verë të vitit 2018, dhe i cili synonte trajtim gjithëpërfshirës të ndërtimeve pa leje, si dhe krijimin e procedurave të thjeshtëzuar për ta mundësuar legalizimin dhe për t'i ndihmuar qytetarët që të realizojnë përfitime nga ndërtimet e tyre", ka njoftuar "EC Ma Ndryshe".

Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë se aplikacionet për certi-

fikatë legalizimi dhe për leje legalizimi për përfundim të ndërtimit mund të dorëzohen brenda dy viteve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe se Ministria me vendim mund ta vazhdojë afatin për dorëzimin e aplikacioneve për dy herë radhazi dhe se afatet e vazhduara nuk mund të tejkalojnë dymbëdhjetë muaj secili.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në gusht të vitit 2020 ka marrë vendim për vazhdimin e afatit për dorëzimin e aplikacioneve për legalizimin e ndërtimeve pa leje, deri më 4 shtator 2021, duke marrë në konsideratë nevojën për kohën shtesë për ta arritur qëllimin e ligjit, sikurse edhe mungesën e kapaciteteve të komunave për zbatimin e ligjit si dhe rrethanat e krijuara gjatë kohës së pandemisë. "Pandemia, sikurse edhe numri i kufizuar i stafit administrativ dhe përvoja e pam-

jaftueshme në këtë fushë, bashkë me aspektet e pazgjidhura të çështjeve pronësore, mosinformimi i duhur i qytetarëve, janë disa nga sfidat e përbashkëta që janë cekur nga komunat. Gjithashtu, komuna të caktuara kanë pohuar se legalizimi si proces ka inkorporuar 3 drejtori për shqyrtim të dokumentacionit, përfshirë këtu edhe nevojën për konsultimet me ministrinë, gjë që ka bërë që shqyrtimi të zgjatet në kohë", ka njoftuar "EC Ma Ndryshe".

Duke qenë se sipas komunave pandemia ka ndikuar në rënie të numrit të kërkesave dhe mosinteresim të qytetarëve për legalizim, "EC Ma Ndryshe" u ka bërë thirrje institucioneve përgjegjëse që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura, përfshirë edhe fushata të informimit, në mënyrë që ky proces mos të dështojë sikurse vite më parë.



## Pacolli takon ministrin e Jashtëm të Turqisë

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), deputeti Behgjet Pacolli, ka takuar në Ankara ministrin e Jashtëm të Turqisë, Mevlut Çavusoglu. Pacolli ka bërë me dije se me Çavusoglu

biseduan për bashkëpunimin e afërt të dy vendeve dhe popujve tanë. "Me mikun tim, ministrin e Jashtëm të Turqisë, Mevlut Çavusoglu, sot në Ankara biseduam për bashkëpunimin e afërt të dy

vendeve dhe popujve tanë. Ministri Çavusoglu dhe Turqia gjithmonë janë pranë popullit të Kosovës si një ndër aleatët kryesorë", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

## Gresa Caka-Nimani zgjidhet kryetare e re e Gjykatës Kushtetuese

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Në seancën administrative të mbajtur të hënën, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës kanë

zgjedhur kryetare të re të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtaren Gresa Caka-Nimani. Gjyqtarja Caka-Nimani do të

fillojë ta ushtrojë detyrën e kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, më 26 qershor 2021, pasi që të përfundojë mandati i

kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi. Mandati i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është tri vjet.





# EULEX-i dhuron një donacion për QKUK-në

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 MAJ - Klinika e Endokrinologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka pranuar një donacion nga EULEX-i. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë e ka dhuruar këtë donacion i cili përmban inventar, pajisje kompjuterike, fotokopje dhe materiale të tjera për zyrat e personelit shëndetësor.

Drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, dr. Valbon Krasniqi, e falënderoi Bashkimin Evropian për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë

Kosovës, sidomos sektorit të shëndetësisë gjatë kohës së pandemisë Covid-19. "Gjatë këtyre muajve gjithmonë kemi pasur në krahë miqtë tanë ndërkombëtarë të cilët në një formë ose tjetër e kanë lehtësuar punën tonë. Ky donacion është dëshmi e bashkëpunimit dhe mbështetjes së ofruar nga Bashkimi Evropian. Falënderojmë për këtë donacion misionin e EULEX-it. Ne ju sigurojmë se të gjitha këto do të përdoren sipas destinimit dhe do të kujdesemi që t'i mirëmbajmë ato", ka thënë Krasniqi.

Në këtë ceremoni solemne mori pjesë edhe kryesuesja e

Bordit të ShSKUK-së, Agreta Gecaj-Gashi, e cila ka shprehur mirënjohjen e saj për ndihmën e ofruar, veçmas në këtë kohë sfiduese me pandeminë.

Shefi i EULEX-it, Lars-Gunnar Wigemark, që dorëzoi donacionin, kujtoi dhe vlerësoi lart rolin e mjekëve dhe të infermierëve në shoqëri, derisa ka theksuar se ata meritojnë më shumë. "Unë e di sa e rëndësishme është puna juaj. Ajo vlerësohet lart, sepse ju keni bërë një betim për t'i ndihmuar njerëzit që kanë nevojë. Kemi ardhur të sjellim këtë donacion që t'ju ndihmoj juve. Janë disa pajisje që kanë qenë për ne, por nuk i kemi përdorur, sepse kemi vlerësuar



që janë më të rëndësishme për ju", ka thënë Wigemark.

Drejtoresha e Endokrinologjisë, Venera Berisha-Muharremi, duke falënderuar misionin e EULEX-it, ka pohuar se është befasuar që kërkesa e saj është

aprovuar menjëherë. "Kam bërë kërkesën për donacion në EULEX. Jam befasuar për të mirë që kjo kërkesë është trajtuar me prioritet dhe është aprovuar menjëherë", ka deklaruar Berisha-Muharremi.

## FSK-ja po fuqizon kapacitetet operationale taktike

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rrahman Rama, dhe sekretarja e përgjithshme Rozafa Ukimeraj, ka vizituar kontingjentin e ri të automjeteve taktike HMMVW të radhitura në pistën e kazermës së FSK-së "Adem Jashari".

Në komunikatën për media të Ministrisë së Mbrojtjes është theksuar se FSK-ja po fuqizon kapacitetet e veta operationale taktike, duke shtuar kapacitetet me pajisje të reja, të blera sipas buxhetit të planifikuar dhe planit të zhvillimit dhjetëvjeçar të FSK-së. "Rritja e kapaciteteve me pajisje taktike po bëhet në harmoni me Planin Gjithëpërfshirës të Transformimit dhe ngritjeve të



kapaciteteve të FSK-së për ta kryer misionin e vet kushtetues.

Ngritja e kapaciteteve teknike të FSK-së dita-ditës tregon se ajo

po ngrehet sipas standardeve të NATO-s", është thënë në

komunikatën e Ministrisë së Mbrojtjes.

## Rexhep Kadriu largohet nga AAK-ja pas 21 vjetësh



PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Rexhep Kadriu ka bërë me dije se ka dhënë dorëheqje nga të gjitha pozitat në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Kadriu përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar se në takimin që ka pasur para disa ditësh me

kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinaj, ka kërkuar që të lirohet nga të gjitha pozitat e AAK-së. "Pas 21 vjetësh të rrugëtimit tim në politikë, e nga dita e parë e themelimit të Degës së AAK-së në Gjilan, kam vendosur që t'i pushoj të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e mia në politikë.

Në takimin që kisha para disa ditësh me kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinaj, i kam kërkuar që të më lirojë nga të gjitha pozitat e AAK-së, ndërsa nga sot nuk kam asnjë pozitë në parti. Arsyja e largimit tim është krejtësisht personale dhe tani e tutje kohën time do t'ia kushtoj

familjes sime. Andaj, dua t'i falënderoj të gjithë qytetarët për mbështetjen e tyre deri sot, dhe të gjithë aktivistët e AAK-së, posaçërisht kryetarin Haradinaj për mbështetjen e vazhdueshme në shumë projekte për Anamoravën sa isha zëvendësministër", ka thënë Kadriu.

## 46 grante janë duke u realizuar në Komunën e Mitrovicës

MITROVICË, 17 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka drejtuar të hënën mbledhjen e radhës e Bordit të Drejtorëve, ku janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i Bordit dhe drejtorive komunale. Drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka njoftuar ekzekutivin se vendimi për bartjen e të hyrave vetjake

nga viti 2020 në vitin 2021 për Komunën e Mitrovicës është buxhetuar dhe pritet që alokimi të bëhet gjatë ditëve në vijim.

Ndërsa drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani, i ka informuar të pranishmit lidhur me procesin e vaksinimit në Komunën e Mitrovicës. Ajo ka thënë se procesi i vaksinimit është duke vazhduar sipas planit të vaksinimit të Ministrisë së

Shëndetësisë. "Aktualisht kemi pranuar 570 vaksina 'AstraZeneca' si dhe 90 vaksina 'Pfizer'. Vaksinimi ka vazhduar edhe përgjatë ditëve të vikendit, ku të shtunën janë vaksinuar 127 qytetarë, ndërsa të dielën janë vaksinuar 110 qytetarë", ka thënë Hasanaj-Barani.

Drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ekrem Sadiku, ka shpalosur informata mbi realizimin e projektit të komunës me organizatën



"Chatar Charity", duke theksuar se janë 46 grante që

janë duke u realizuar, në vlerë prej 56 555 mijë eurosh.



## Kapen 400 kilogramë kokainë në Kosovë

PRISHTINË, 17 MAJ - Në Kosovë është kapur një sasi e madhe droge. Bëhet fjalë për 400 kilogramë kokainë. Mësohet se droga vinte nga vendet e

Amerikës Latine. Kokaina është kapur në një kamion me mish, i cili vinte nga Brazili. Kapja e saj ka ardhur si rezultat i një operacioni mes policisë

shqiptare, policisë italiane dhe asaj të Kosovës. Sinjali ka ardhur nga DEA amerikane. Droga prej tre ditësh është nisur drejt Kosovës, ku dhe është

sekustruar. Kamioni ka hyrë nga Italia në Portin e Durrësit 15 ditë më parë. Mësohet se pakove dhe kontejnerëve u është vendosur çip.



## Në Fakultetin Ekonomik mbahet ligjëratë virtuale për stabilitetin makro-fiskal

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar Financiar, Divizioni i Makroekonomisë ka mbajtur të hënën ligjëratë virtuale me studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës me temën "Çfarë është stabiliteti makroekonomik". Ligjëratë është mbajtur për

studentët e vitit të parë si pjesë e lëndës së Makroekonomisë, ku udhëheqësja e divizionit Esida Bujupi ka bërë prezantimin mbi rolin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, konkretisht të Divizionit të Makroekonomisë në procesin e hartimit të buxhetit, sigurimit të stabilitetit makro-fiskal dhe ruajtjen e rregullave fiskale. Studentët pjesëmarrës në këtë

ligjëratë bashkë me ligjëruesen Esida Bujupi diskutuan për sfidat për sigurimin e qëndrueshmërisë së financave publike si dhe për përmirësimin e transparencës fiskale. Ata u pajtuan se pandemia ka krijuar sfida domethënëse fiskale, por se financat e qëndrueshme publike janë thelbësore për një rimëkëmbje ekonomike pas pandemisë si dhe treguan

interesim mbi angazhimin e tyre në të ardhmen në institucionet publike.

Ligjëratë e mbajtur në Fakultetin Ekonomik është organizuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Divizioni i Makroekonomisë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me mbështetje të Programit të USAID-it për Qeverisje Ekonomike në Kosovë.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve planifikon të mbajë një seri të ligjëratave të tilla në të ardhmen në universitetet private dhe publike në Kosovë për t'i zgjeruar njohuritë e ekonomistëve të ardhshëm mbi rëndësinë e stabilitetit makro-fiskal si dhe për ta rritur ndërveprimin e politikëbërjes publike me akademinë.



## FMN-ja: Kosova dhe Shqipëria, tri herë më të varfra se vendet e Perëndimit

PRISHTINË, 17 MAJ - Kosova dhe Shqipëria janë dy shtetet qytetarët e të cilave mund të blejnë më pak mallra dhe produkte në Evropë duke marrë në konsideratë të ardhurat e tyre vjetore për frymë. Të dhënat janë përditësuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) që publikon treguesin e prodhimit të brendshëm për frymë, sipas standardeve të fuqisë blerëse, në dollarë ndërkombëtarë për vitin 2020 ishte 14.2 mijë dollarë, shifër që është 5.5 për qind më e ulët sesa Bosnja e Hercegovina, që renditet para dhe 33 për qind më e ulët sesa në Serbi dhe Mal

dollar ndërkombëtar ka të njëjtën fuqi blerëse mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) si një dollar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sipas FMN-së, në Shqipëri, PBB për frymë, sipas standardeve të fuqisë blerëse, në dollarë ndërkombëtarë për vitin 2020 ishte 14.2 mijë dollarë, shifër që është 5.5 për qind më e ulët sesa Bosnja e Hercegovina, që renditet para dhe 33 për qind më e ulët sesa në Serbi dhe Mal

të Zi, që janë dy shtetet e rajonit me më shumë të ardhura për frymë. Edhe në krahasim me Maqedoninë e Veriut, ky tregues është 30 për qind më i ulët. Shqipëria renditet në vendin e 90-të në botë dhe lë pas vetëm Armeninë (93), Ukrainën (95), Moldavinë (98), ndërsa Kosova është absolutisht më e varfra e Evropës, me 11.2 mijë dollarë amerikanë për frymë, duke u renditur në vendin e 108 në botë.





## Nga tërheqja e 10-përqindëshit në Trust fituan edhe bankat

PRISHTINË, 17 MAJ - Nga tërheqja e 10-përqindëshit në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës bankat komerciale në Kosovë kanë rritur fitimet e tyre. Kjo është bërë me dije në raportin e stabilitetit financiar janar - dhjetor 2020 i publikuar para pak ditëve nga Banka Qendrore e Kosovës. Sipas BQK-së, depozitat në banka, të cilat në dhjetor 2020 përbënin 81 për qind të burimeve të financimit, shënuan rritje vjetore prej 12-përqindësh, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të transferueshme të ekonomive familjare, të nxitura nga kursimi më i madh si rezultat i rritjes së pasigurive, tërheqja e 10-përqindëshit të kursimeve pensionale dhe niveli më i lartë i remitencave. "Tërheqja e 10 për qind të mjeteve pensionale ka ndikuar në rritje të theksuar të aseteve të sektorit bankar, të cilat në dhjetor u shtuan për 225.6 milionë euro krahasuar me 78.3

milionë euro në nëntor 2020 (mesatarja mujore e rritjes gjatë periudhës janar-nëntor 2020 ishte për 33.4 milionë euro)", thuhet në raport.

Edhe niveli i depozitave në dhjetor 2020 u rrit për 215.4 milionë euro krahasuar me 66.9 milionë euro në nëntor 2020 (mesatarja mujore e rritjes gjatë periudhës janar-nëntor 2020 ishte 21.4 milionë euro).

Në dhjetor të vitit 2020 niveli i rezervave mbi rezervën e obliguar ishte për 302.1 milionë euro më e lartë, që është dukshëm më e lartë se plus 179.6 milionë euro në muajin paraprak dhe plus 186.6 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Transferimi i mjeteve pensionale në llogari bankare të qytetarëve ka ndikuar edhe në rritje të theksuar të numrit dhe vlerës së transaksioneve përmes sistemit të pagesave i cili operohet dhe



mbikëqyret nga BQK-ja. "Numri i transaksioneve të kategorisë 'pagë/pension' në dhjetor 2020 arriti vlerën në 879.5 mijë sosh

(mesatare mujore prej 472.5 mijë sosh gjatë periudhës janar-nëntor 2020), kurse vlera e transaksioneve arriti në 316

milionë euro (119.9 milionë euro mesatarja mujore gjatë periudhës janar - nëntor 2020)". (kp).

## KEDS-i ka investuar mbi 28 milionë euro në rrjetin nëntokësor

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Kompania Kosovare për Distribim të Energjisë Elektrike (KEDS) po vazhdon të investojë fuqishëm në shtrirjen e rrjetit nëntokësor gjithandë vendit. Deri më tani, mbi 28 milionë euro janë investuar në rrjetin nëntokësor në shtatë distriktet në kuadër të mbi 140 projekteve të KEDS-it. "Tashmë shumica e qendrave të qyteteve janë me rrjet nëntokësor, derisa synimi i KEDS-it është që brenda një të ardhme të shkurtër të përfshijë të gjitha në nivel Kosovë. Këto investime po bëhen në bashkëpunim edhe me komunat. Me shtrirjen e rrjetit elektrik nëntokësor KEDS-i po krijon infrastrukturë të re energjetike derisa me qindra shtylla po largohen duke ua kthyer pamjen e merituar zonave turistike, qendrave të qyteteve dhe vendeve historike",

thuhet në njoftimin e KEDS-it. Sipas këtij njoftimi, krijimi i infrastrukturës së re po i bën zgjidhje një herë e mirë rrjetit të stërvjetruar që KEDS-i ka trashëguar. "Kështu, po rriten kapacitetet duke rritur sigurinë e furnizimit me energji të qëndrueshme e kualitative dhe po zëvendësohen me qindra kilometra kablo. Përmes këtyre investimeve nëntokësore po krijohen edhe linjat alternative që do të mundësojnë furnizim alternativ në rast avarie pasi, nëse një dalje e asaj linje është në defekt, menjëherë furnizimi kalon në daljen alternative dhe kështu konsumatori nuk ballafaqohet me ndërprerje të energjisë elektrike", është theksuar në këtë njoftim.

KEDS-i ka bërë me dije se për tetë vjet të operimit në Kosovë ka investuar mbi 170 milionë euro në modernizim të rrjetit.



"Investimet në rrjetin elektrik po vazhdojnë çdo ditë anekënd Kosovës, që tregon

përkushtimin e kompanisë për përmbushjen e premtimeve dhe vendosmërinë për të qenë sa më

afër konsumatorit", është thënë në fund të këtij njoftimi të KEDS-it.

## BQK-ja: Diaspora solli rreth 1 miliard euro në vitin 2020

PRISHTINË, 17 MAJ (ER) - Rreth 1 miliard euro kanë dërguar bashkatdhetarët gjatë vitit 2020, në kulmin e pandemisë, duke shënuar rekord të 'prurjeve' nga diaspora ndër vite. Kjo shifër është bërë me dije nga ana e Bankës Qendrore e Kosovës (BQK). "Remitencat arritën vlerën prej 980.1 milionë eurosh në vitin 2020 dhe shënuan rritje vjetore prej 15.1-përqindësh duke arritur në 14.4 për qind të BPV-së", thuhet në raportin e

BQK-së mbi stabilitetin financiar për vitin 2020. Sipas këtij raporti, remitencat përmes operatorëve që transferojnë para kanë shënuar rritje më të lartë për 60 për qind, ndërsa remitencat përmes bankave kanë shënuar rritje për 14.9 për qind. Në anën tjetër, duke pasur parasysh masat kufizuese në udhëtim, remitencat që vijnë përmes "kanalit joformal" kanë shënuar rënie prej 46-përqindësh.





# Strategjia e shërbimit sekret serb për ta shkatërruar strukturën e UÇK-së pas vitit 2000 e këndeje (5)



**Faton B. MEHMETAJ**

Pjesëtarët e “Klanit të Zemunit”, të prirë nga Milorad Llukiq-(Legia), që organizuan vrasjen e kryeministrit serb Zoran Gjingjiq, kanë qenë të pajisur me pasaporta diplomatike dhe kohë pas kohe kishin udhëtuar në Kolumbi, Federatën Ruse, Kinë dhe Shqipëri. Pjesëtarët e këtij grupi kishin status diplomatik. “Klani i Zemunit”, pos vrasjeve që i kanë kryer në Serbi dhe Kosovë, kanë kryer vrasje edhe në Shqipëri. Legia për krimet e bëra gëzonte privilegje, siç janë tregtia e lirë me drogë dhe me njerëz si dhe likuidimi i të gjithë atyre të cilët ia zinin rrugën për çfarëdo arsyeje. Legia kishte kontakte edhe me Tribunalin e Hagës. Nuk duhet harruar se Milorad Llukiqin-(Legia) e kishte angazhuar në njësinë e “Beretave të Kuqe” vetë shefi i shërbimit sekret serb Jovica Stanishiq. Legia një kohë ishte zëvendës i Frenki Simatoviçit i cili ishte komandant i Njësisë për Operacione Speciale. Milorad Llukiq-(Legia) edhe pasi u largua Stanishiqi nga puna, u lidh me shefin e ri të shërbimit sekret serb Radomir Markoviçin i cili e përparoi në gradë atë. Legia ishte takuar më 4 tetor 2000, me Gjingjiqin, që i bie një ditë para se Millosheviçit të rrëzohej nga pozita. Ai ishte marrë vesh me Gjingjiqin që të mos intervenonte kundër protestuesve në protestat që ishin organizuar kundër falsifikimit të zgjedhjeve në Serbi, dhe ashtu doli. Takimi në fjalë mes Gjingjiqit dhe Legias ishte sinjal i qartë se ngjarjet e tetorit të vitit 2000 nuk ishin kurrfarë revolucioni demokratik, veçse një dorëzim i shtabit të Millosheviçit në gjirin e opozitës, që atëherë drejtohej nga Gjingjiq, Koshtunica dhe nxënësi i zellshëm i Millosheviçit, ish-prefekti i Beogradit, Nebojsa Çoviç.

Në kuadër të hetimeve për t'i gjetur dhe për të arrestuar vrasësit e Zoran Gjingjiqit i cili u vra pse ishte marrë vesh me qarqet ndërkombëtare për ta dorëzuar Millosheviçin në Hagë, policia serbe, lidhur me organizimin e kësaj vrasjeje, e kishte marrë në bisedë informative edhe ish-shefin e Shtabit të Përgjithshëm të “UJ”,

Nebojsa Pavkoviç. Sepse vrasja e Gjingjiqit ishte një komplot i organizuar nga forcat e ashtuquajtura patriotike të Serbisë të udhëhequra nga kriminelët e luftës, përfituesit e luftës, patronazhët dhe iniciatorët e krimeve politike nga radhët e regjimit të Millosheviçit. Diçka ngjashëm me këto që po i them unë ishte shkruar edhe komunikata e MPBS së Serbisë rreth vrasjes së Gjingjiqit. Legia bashkë me Zhelko Azhnjatoviçin (Arkanin dhe Radovan Stojçiqin (Baxha) organizuan agresionin serb në Kroaci, por edhe në Kosovë. Madje Legia i kishte trajnuar njësitet e paramilitarëve serbë dhe “tigrat” e Arkanit në bazën e paramilitarëve në Erdut të Sllovenisë Lindore, të cilët në Kroaci, Bosnje, Kosovë e vende të tjera të ish-Jugosllavisë kanë vlarë mijëra civilë dhe kanë plaçkitur çfarë kanë dashur. Këto struktura në bashkëpunim me shërbimet sekrete serbe organizuan mjeshtërisht trazirat e marsit të vitit 2004 ku, pos të tjerash, u dogjën edhe disa kisha serbe të ndërtuara me qëllime politike gjatë periudhës së viteve '90, ku shërbimi sekret serb, i ndihmuar edhe nga mediumet e propaganda serbe, e hodhi fajin mbi UÇK-në. Por për trazirat e marsit 2004 bota e qytetëruar e mori vesh shpejt se këto janë pjellë e shërbimit sekret serb dhe i gjithë procesi kaloi në heshtje dhe u mbyll pa zhurmë të madhe. I tregova këto ngjarje sepse drejtuesit e tyre me theks të veçantë që nga viti 1990 e këndeje janë promotorët e të gjitha problemeve që i shkaktoi Serbia dhe aparatura e Millosheviçit në Kosovë. Nga kjo kohë shërbimi sekret serb i kishte aktivizuar njësitë agjenturore nga radhët e shqiptarëve në Kosovë dhe diasporë për të lansuar sa më


shumë dezinformata e thashetheme për ta mbajtur aktive maksimumin e vjetër përçarje e sundo, metodë kjo që u përdor nga këto shërbime për ta nxitur vëllavrasjen dhe pakënaqësi të tjera. Madje mbi këtë bazë u ngritën dhjetëra e dhjetëra gjyqe nga gjyqësia kosovare e ndihmuar nga ajo e UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë kundër pjesëtarëve të UÇK-së. Të gjitha këto struktura bashkë gradualisht instaluan padukshëm në disa segmente të administratës në Kosovë, strukturën e vet, përmes të cilëve e sabotonin ngadalë dhe pahetueshëm çdo gjë që lidhej me UÇK-në. Kuptohet në këto mekanizma që i ka kombinuar dhe përdorur shërbimi sekret serb kundër UÇK-së janë të gjithanshme dhe në to janë të angazhuar të gjitha profilet prej bujkut e deri në popi e intelektualit i profilit akademik. Për t'i arritur këto qëllime dhe për të pasur sukses në realizimin e këtyre qëllimeve shërbimet serbe dhe Serbia kishin vënë në dispozicion mjete financiare dhe shuma marramendëse për ata që ishin pjesë e këtyre projekteve. Të njëjtët në vitin 2001 dizajnuan projektin afatgjatë të hakmarrjes ndaj strukturave të UÇK-së, duke i përdorur të gjitha mjetet dhe mundësitë e shtetit serb, miqve të Serbisë dhe Rusisë për t'i arritur qëllimet rreth realizimit të këtij projekti. Njësitë e “Beretave të Kuqe”, të njohura edhe si njësitë e JSO-s apo “Frenkie Boys”, thirrshin në emër të Frenki Simatoviçit që ishte themelues i kësaj njësie, erdhën në Kosovë në fillim të vitit 1998. Edhe këto të involvuara në vrasjen e Gjingjiqit. Në organizimin e vrasjeve të pasluftës u zunë nga Policia e Kosovës dhe KFOR-i edhe disa vrasës me pagesë, disa prej të cilëve janë dënua me burgim për

veprat e kryera e që nuk lidhen me strukturat e UÇK-së. BE-ja, KFOR-i, EULEX-i dhe instancat e tjera të sigurisë ndërkombëtare, por edhe vendore duhet të merren me këto problematika të cilat e përbëjnë thelbin e të gjitha problemeve në Kosovë që kanë ndodhur para luftës në Kosovë, gjatë luftës dhe pas mbarimit të saj duke e përfshirë edhe kohën e ngjarjeve e deri në ditët tona. Gjerë më tani prej të gjithëve u abuzua me fjalën “askush mbi ligjin”, kjo maksimum shërbeu për ta shtypur e degraduar vetëm strukturën e UÇK-së. Edhe sot ka njerëz në misionin për sundimin e ligjit që punojnë në Kosovë që janë me mentalitetin e UNMIK-ut të cilët vazhdojnë ta shohin Kosovën jo si shtet të pavarur, por si protektorat i UNMIK-ut. Kjo shtresë administrative e shfrytëzoi rastin ta shkatërrojë çdo zë të pavarur që pat guxim për ta ngritur zërin e për të kritikuar. Për shkak të aktiviteteve të shtuara të shërbimit sekret serb, të cilët organizuan një fushatë të egër propaganduese kundër UÇK-së brenda dhe jashtë Kosovës, që nga viti 2000 organizata të ndryshme ndërkombëtare që merreshin me problemet e ndryshme botërore, duke filluar nga ajo e Grupit Ndërkombëtar të Krizave (International Crisis Group-ICG), OSBE-ja, e organizata të tjera ndërkombëtare dhe rajonale, për një kohë bukur të gjatë, pjesë e raporteve të tyre ishte veprimtaria e pjesëtarëve të UÇK-së. U shkatërrua që në fillim pothuajse çdo iniciativë që buronte nga vendorët dhe i shërbente vendit. Sikurse UNMIK-u edhe EULEX-i u tregua i njëanshëm ndaj strukturës së UÇK-së. Kjo njëanshmëri ishte vërejtur që në fillim të mandatit të këtij misioni. Madje rreth këtyre shkeljeve ky

mision pati shumë afëra të cilat u bënë edhe mediatike. Nuk u ndal për asnjë çast veprimtaria e strukturave paralele serbe në Kosovë, kontrabanda me derivate e mallra të tjera në veri vazhdon që 20 vjet, mafia serbe nga kjo kontrabandë i fiton 5 deri 10 milionë euro çdo vit, gjithandë nëpër Kosovë kanë vepruar e vepronin operatorët ilegalë të telefonisë serbe, në më shumë se 30 për qind të territorit të Kosovës nuk ka liri të lëvizjes dhe siguri për qytetarët e Kosovës, në shumë vende të Kosovës bëhet tregtia me dinarë (valutë serbe). Mitrovica është e ndarë me rampë, në pjesën veriore qeveritë e Kosovës nuk kanë pasur qasje asnjëherë, eksterritorialiteti është territor i uzurpuar dhe i kontrolluar në të shumtën e rasteve nga qeveria serbe. Qytetarët e Kosovës edhe sot janë të pajisur me dy parë tabela në vetura KS dhe RKS, pra ato që kanë të drejtë të dalin në Serbi dhe në ato që nuk kanë të drejtë. Serbia përmes listës serbe vazhdimisht e kërcënon sovranitetin e Kosovës dhe sigurinë e brendshme. Kësaj situatë që është në disfavor të Kosovës i ka ndihmuar edhe fakti i mosshuarjes së strukturave paralele të cilat janë bërë pjesë e cancerogjengjeve për zhvillimin e Kosovës. Kosova furnizohet në 70 për qind të rasteve nga mallrat serbe. Mbi 30 mijë shqiptarë janë të pajisur me dokumente e shtetësi të Serbisë, mbi 10 mijë të tjerë për shkaqe të punësimit e të rregullimit të dokumentacionit janë detyruar ta mohojnë shtetësinë e Kosovës. Këto fenomene të cilat e dëmtojnë Kosovën askush nuk i sheh e askush nuk i ndalon, por që herët a vonë kërkojnë zgjidhje, në të kundërtën Kosova nuk ka progres. Është parë dhe është bërë tashmë e ditur se struktura e UÇK-së u godit nga shërbimi sekret serb, rus dhe u ndihmuar nga shtetet mike të Serbisë dhe Rusisë për ta shtrirë ndikimin e tyre papengueshëm sepse këta ishin pengesa kryesore. Edhe përkundër këtyre pengesave dhe tejzgjatjes së bisedimeve prej të cilave Serbia bleu kohë të mjaftueshme për t'i goditur e shkatërruar kundërshtarët e vet në Kosovë, shteti i Kosovës do të mbetet ndër shtetet e forta të ish-Jugosllavisë dhe të Evropës Perëndimore, me perspektivë për t'u integruar me Shqipërinë, shqiptarët e Maqedonisë, Malit të Zi e të Kosovës Lindore. Kosova ka miq të fuqishëm ndërkombëtarë dhe ka kapacitete intelektuale dhe politike për t'i zgjidhur problemet që i ka krijuar Serbia në bashkëpunim me Rusinë dhe përkrahësit e tjerë. (Fund)







**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Kastrati: Triumfi në Superligë dhe Ligën Unike, sukses i jashtëzakonshëm



PRISHTINË, 17 MAJ - Erjon Kastrati në stinorin pranveror iu bashkua Golden Eagle Yllit, ku arriti sukses të dyfishtë, duke triumfuar në Ligën Unike dhe FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Erjoni ishte edhe MVP i Ligës Unike. Skuadra nga Theranda ka investuar mjaft në vitet e fundit, kurse në këtë edicion arriti që t'i fitojë titujt e parë në histori të klubit. Fituan edicionin e parë të Ligës Unike, si dhe fituan për herë të parë titullin në Superligën e Kosovës.

Therandasit, po ashtu, ishin finalistë të Kupës. Njëri nga lojtarët më të dalluar ishte Erjon Kastrati. Ai erdhi nga Koper Primorska. "Ka qenë një edicion i suksesshëm. Kemi fituar dy tituj dhe kemi arritur një finale. Nuk është lehtë të fitohet në asnjë Ligë të botës, sidomos në këtë edicion të Superligës së Kosovës në basketboll, ku kishte shumë konkurrencë. Jam krenar me ekipin tim", ka thënë Kastrati për faqen zyrtare të FBK-së. "Ka qenë

liga më e barabartë në 20 vjetët e fundit. E konsideroj arritje të madhe që kemi fituar Ligën Unike dhe FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Skuadrat kanë qenë të përforcuara. Ka pasur konkurrencë të madhe dhe cilësi. Cilado skuadër të shpallej kampione nuk do të ishte befasi, sepse e kemi parë se gjatë kampionatit secila e ka mundur njëra-tjetrën. Edhe finalët nuk kanë qenë të lehta, pasi në tri ndeshjet fituesi është vendosur në minutat e fundit. Besoj se me meritë jemi shpallur kampione në fund", ka shtuar anëtari i Përfaqësueses së Kosovës në basketboll.

Për të arritur këto suksese Erjoni ka punuar shumë. "Asgjë nuk është e rastësishme. Puna paguhet. Herët apo vonë vjen shpërblimi për punën e bërë. Duhet të stërvitemi e të punojmë shumë dhe sigurisht se suksesi nuk do të mungoj. Ata që duan të merren me sport duhet të jenë sa më profesionistë", nënvizon

26-vjeçari. Përveç punës, Kastrati është shembull, duke mos pasur polemika me kundërshtarë, gjyqtarë apo tifozë. "Në fund të ditës ne të gjithë jemi sportistë. Të gjithë duam të fitojmë, por duhet ta kontrollojmë veten. Duhet t'i respektojmë edhe kundërshtarët e tifozët. Kosova është një vend i vogël dhe ne prapë në fund të ditës jemi së bashku, andaj duhet të kemi respekt", ka shtuar ai. Mesazhi për fëmijët që duan të merren me basketboll është i qartë. "Duhet të punojnë shumë dhe të besojnë në ëndrrat e tyre. Sigurisht se puna do të shpërblehet". Erjon Kastrati është ndër lojtarët më të dalluar të Kosovës. "Fanella e shtetit tënd ka rëndësi të madhe. Unë jam krenar që luaj për Kosovën dhe jap kontributin tim. Edhe për lojtarët e rinj kam një mesazh që të punojnë dhe të stërviten shumë në mënyrë që një ditë ta përfaqësojnë vendin në garat ndërkombëtare", ka përfunduar Kastrati.

## SHKURT

### Januzaj nuk ftohet nga Belgjika për Kampionatin Evropian

BRUKSEL, 17 MAJ - Futbollisti me prejardhje nga Kosova, Adnan Januzaj, nuk është ftuar në ekipin kombëtar të Belgjikës për Kampionatin Evropian 2020 që do të mbahet muajin e ardhshëm. Sulmuesi i Real Sociedadit është lënë në listën e gatishmërisë nga trajneri Roberto Martinez. Ai mund të ftohet në turneun e verës që nis më 11 qershor në rast se ndonjëri prej sulmuesve të ftuar detyrohet të tërhiqet nga ekipi. 26-vjeçari e përfaqësoi Belgjikën dy herë në Kupën e Botës, më 2014 dhe 2018, duke e shënuar një gol. Trajneri Martinez i ftoi shtatë sulmues, Eden Hazard, Romelu Lukaku, Jeremy Doku, Dries Mertens, Leandro Trossard, Mitschi Batshayi dhe Christian Benteke.

### Ronaldo gjithnjë e më larg Juventusit

Cristiano Ronaldo mund të largohet nga Juventus. Bardhezinjtë presin ndonjë dhuratë nga Atalanta ose Hellas Verona në javën e fundit të Serisë A, përndryshe do të luajnë në Ligën e Evropës sezonin e ardhshëm. Ylli portugez nuk dëshiron të mbesë pa Ligën e Kampionëve në këto pak vite karrierë që i kanë mbetur. Ditët e fundit është folur shumë në lidhje me largimin e 36-vjeçarit, ndërsa veprimi i fundit ka shtuar dyshimet e tifozëve. Të dielën në mbrëmje sulmuesi ka ngarkuar në një kampion të një kompanie të njohur transporti portugeze të shtatë makinat luksoze që zotëron. Shenja lamtumire, teksa rikthimi te Sportingu është një nga opsionet.

### Reja: Gjimshiti është një nga pesë mbrojtësit më të mirë në Evropë

Trajneri i Shqipërisë, Edy Reja, ka folur për mediat italiane edhe sa i përket rritjes së Berat Gjimshitit, duke e futur në mesin e pesë mbrojtësve më të mirë në Evropë. Kur flitet për finalen e Kupës kundër Juventusit, trajneri i Kombëtares është i sigurt se Atalanta nuk do të ndryshojë asgjë në lojën e saj për hir të trofeut. "Jam i sigurt se Atalanta do ta luajë ndeshjen e saj kundër Juventusit. Gasperini do të përballet ndaj Juventusit si një ekip që nuk mendon vetëm për Ronaldon dhe pa hequr dorë nga futbolli i saj. Më pëlqen që ta shoh Atalantën në çdo ndeshje se nuk i mungon asgjë. Gjimshiti? 'Gimmi' është një nga pesë mbrojtësit më të mirë në Evropë. Është rritur shumë. Milani kërkon fitoren ndaj Atalantës? Mund të ndodhë gjithçka, por Milani i komplikoi jetën vetes. Nuk fiton dot lehtë në Bergamo", ka thënë Reja.

## Të premtën zhvillohet ndeshja e barazhit në mes të Dukagjinit dhe Flamurtarit

PRISHTINË, 17 MAJ - Dukagjini dhe Flamurtari do të ndeshen në kuadër të barazhit të Ligës së Parë. Kjo ndeshje do të zhvillohet të premtën në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas nga ora 15:00. Fituesi i kësaj përballje më pas do të luajë ndeshjen e barazhit për hyrje në Superligën e

Kosovës, me skuadrën e cila në fund të kampionatit do të renditet në pozitën e tetë. Në rast të fitores ndaj kësaj skuadre, atëherë Dukagjini apo Flamurtari do të luajnë në Superligë në sezonin e ardhshëm. Ulpiana dhe Malisheva kanë siguruar kualifikimin nga Liga e Parë në Superligë pa barazh.

Në anën tjetër, vendi i tetë në Superligë mbahet nga Arbëria, por që ka edhe një ndeshje për t'u zhvilluar dhe vetëm një pikë më larg janë Drenica, Feronikeli dhe Llapi të cilat rrezikojnë të bien në pozitën e tetë. Xhiroja e fundit e Superligës do të jetë përcaktuese për këto skuadra.






## Ismajli: Ibra më i forti

**LA SPEZIA, 17 MAJ** - Spezia siguroi qëndrimin në Serinë A një javë para fundit të kampionatit dhe kontribut për këtë arritje të skuadrës modeste italiane ka dhënë edhe mbrojtësi i Shqipërisë, Ardian Ismajli, i cili ishte i ftuar në "Zona Gol", në "SuperSport". "Spezia ka shkruar

historinë në Serinë A pasi shumë njerëz në Itali kanë menduar se ne do të biem nga kategoria. Jemi përshtatur shumë shpejt e ky mendoj se ka qenë çelësi i suksesit për ne. Spezia është për herë të parë në histori në Serinë A dhe na duhen shumë përforsime që sezonin tjetër që

të qëndrojmë në elitë. Do të kemi disa ditë pushim, do të grumbullohem me Kombëtaren e pastaj do të rikthehem te Spezia. Nuk është pak të vish nga Kosova të luash në Kroaci e më pas në Serinë A", ka deklaruar ai. Ismajli është përballur me shumë yje në Serinë A. "Besoj se

Ibrahimoviqi është më i rrezikshëm, edhe pse është në moshën më të madhe. Lukaku është një sulmues i fortë, ndërsa kundër Ronaldos nuk kam pasur shumë duele të forta. Ibra ka shumë përvojë dhe është i vështirë për t'u markuar", ka shtuar mbrojtësi nga Kosova.



## Lakersat nuk ndalen, Utah dhe Philadelphia ruajnë kreun

New Orleans, 17 maj - Los Angeles Lakers ka lënë pas krahëve krizën e rezultateve pasi ka triumfuar me rezultatin 98-110 në transfertën ndaj New Orleans Pelicansit, duke regjistruar kështu suksesin e pestë radhazi, që çon edhe më pranë një vendi direkt në "play-off". Kampionët në fuqi të NBA-s e nisën vullshëm ndeshjen dhe morën një avantazh prej tetë pikësh që në fraksionin e parë, ndërsa më pas fituan bindshëm edhe pjesën e tretë, duke ruajtur epërsinë e nevojshme për të triumfuar në të gjithë takimin. LeBron Jamesi ishte protagonist absolut për kalifornianët, pasi ia doli të shënojë 25 pikë, të rikuperojë një top dhe të japë 6 asistime, ndërsa Anthony Davies mbeti disi në hije, pasi nuk shkoi dot përtej 14 pikëve të shënuara. Blindon pozitat në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit Utah Jazz, që ia doli të triumfojë me rezultatin 99-121 në transfertën ndaj Sacramento Kings. Utah dominoi takimin në tre nga katër fraksionet e lojës dhe



siguroi një epërsi të konsiderueshme, çka i dha mundësinë të lëshonte disi në pjesën e fundit. Clarkson ishte protagonist absolut në suksesin e Jazzit me 33 pikë të shënuara, dy rikuperime dhe 3 asistime, ndërsa Sacramento pësoi humbjen e tretë radhazi dhe nuk tashmë ka humbur shpresat për të synuar një vend në "play-off". Në Konferencën e Lindjes vijon të kryesojë me meritë Philadelphia 76ers, që mori një tjetër fitore, këtë herë me rezultatin 128-117 përballë Orlando Magicut. Të udhëhequr nga 20-vjeçari Tyrese Maxey, i cili shënoi 30 pikë,

rikuperoi 7 topa dhe dha 6 asistime, vendasit dominuan në tre nga katër fraksionet e lojës. Nga ana tjetër Orlando bëri mirë vetëm në pjesën e dytë por, pavarësisht prej formës spektakolare të Cole Anthony, i cili shënoi 37 pikë, rikuperoi 8 topa dhe dha 2 asistime, sërish nuk ia doli ta shmangë humbjen. Në sfidat e tjera Brooklyn Nets triumfoi me rezultatin 123-109 ndaj Cleveland Cavaliersit falë një forme mjaft të mirë edhe të Kevin Durantit, ndërsa Portland Trail Blazersi fitoi me rezultatin 132-116 në sfidën ndaj Denver Nuggetsit.

## Në fundjavë turneu kualifikues në 3x3

**PRISHTINË, 17 MAJ** - Federata e Basketbollit e Kosovës këtë fundjavë në Marigona Rezidencë organizon turneun në 3x3 për meshkuj dhe femra. Ekipet fituese në kategoritë përkatëse do ta përbëjnë ekipin përfaqësues të Kosovës që do të marrë pjesë në kualifikimet për FIBA Europe Cup 2021, që sivjet zhvillohen në Constanta të Rumanisë më 26 e 27 qershor 2021.

FBK-ja njofton se në konkurrencën e meshkujve do të garojnë 12 ekipe, kurse në atë të femrave 8 ekipe. Në rast se lajmërohen më shumë ekipe sesa numri i përcaktuar, atëherë përparësi për pjesëmarrje kanë ekipet që kanë pozitë më të mirë në renditjen e FIBA-s. "Kusht për pjesëmarrje të secilit lojtar në



këtë turne është që ta ketë profilin e konfirmuar në platformën e FIBA-s për 3x3 (<https://play.fiba3x3.com>), t'i ngarkojnë fotot dhe shënimet e kërkuara nga FIBA. Procedura e regjistrimit: pas konfirmimit të profileve për secilin lojtar, ekipet mund të regjistrohen në

platformën e FIBA-s (<https://play.fiba3x3.com>), ose të dërgojnë e-mail në [manager3x3@basketbolli.com](mailto:manager3x3@basketbolli.com), ku paraqesin të dhënat e lojtarëve. Afati i fundit për regjistrim: 21 maj 2021, ora 14:00", thuhet në njoftimin e FBK-së.

### SHKURT

#### Muriqi drejt largimit, Tare mendon për sulmuesin e Crotones

Vedat Muriqi nuk mundi të lërë shenjë këtë sezon te Lazio. Vetëm një gol në kampionat dhe një në Kupën e Italisë janë fare pak për bomberin dardan. Sezonin e ardhshëm pritet ta shohim larg kryeqytetit, ndërsa Iglj Tare ka nisur punën për ta gjetur pasuesin e tij. "Sky" raporton se drejtori sportiv i klubit bardhekaltër po synon të transferojë Simy te Lazio. 29-vjeçari ia ka dalë këtë sezon të shënojë 20 gola në Serinë A me Crotonën. Ekipi kalabrez ra në Seribë B dhe largimi i Simy është i paevitueshëm. Për lojtarin ka interesim nga Anglia, por Tare ka nisur negociatat me agjentin e tij dhe po punon për ta mbyllur sa më shpejt operacionin e parë të merkatos së verës.

#### Simeone: Askush si Suarez

Tifozët e Atletico Madridit përjetuan emocione drithëruese të dielën, pasi ekipi i tyre i zemrës arriti një fitore të çmendur ndaj Osasunës. Trajneri Diego Simeone e ka lavdëruar sulmuesin Luis Suarez i cili shënoi golin vendimtar për fitoren e Atletico. "Skuadra zhvilloi një ndeshje të madhe. Krijua shumë raste për gol dhe reaguam në mënyrën e duhur pasi kaluam në disavantazh. Nuk po i finalizonim rastet, por ia dolëm t'i shënojmë golat e fitores në momentin më të vështirë. Suarez? Ai gjendet gjithmonë gati në zonën e golit, ka vendosmëri dhe këmbëngulje të jashtëzakonshme. Ishte i duhuri për ta zgjidhur këtë ndeshje të komplikuar dhe të vështirë", ka thënë Simeone.

#### Gattuso shihet si zëvendësues i Pirlos

Gennaro Gattuso mund të emërohet trajner i ri i Juventusit. "Tuttosport" raporton se "Zonja e Vjetër" po e sheh trajnerin e Napolit si pasardhës të Pirlos. Juventus pati një edicion zhgënjyes të mbetet edhe jashtë Ligës së Kampionëve, prandaj drejtuesit e klubit po synojnë të bëjnë ndryshime në shtabin teknik. Dy opsionet e tjera për postin e trajnerit janë edhe Max Allegri dhe Zinedine Zidane.

#### Zidane e mohon se do të largohet nga Real

Zinedine Zidane ka mohuar t'iu ketë thënë lojtarëve të Real Madridit se do të largohet nga klubi, duke shtuar se "kurrë, kurrë nuk do t'ua thoshte këtë lojtarëve të mi". Publikime të shumta, përfshirë "Goal", kanë konfirmuar se Zidane ka njoftuar largimin e tij nga skuadra pas dyerve të mbyllura, me spekulime se lodhja fizike dhe mendore e trajnerit ishin arsye të mundshme për largimin e tij. Pavarësisht se mundën Athletic Bilbao të dielën, lojtarët e Zidanes janë në rrezik të përfundojnë 2020-21 pa një trofe, pasi ata mbetën dy pikë prapa Atletico Madridit në La Liga. "Si mund t'u them lojtarëve që po largohem tani? Ne po japim gjithçka për titullin dhe unë thjesht në mes të rrugës, të them se jam jashtë?", ka thënë Zidane. "Njerëzit jashtë klubit mund të thonë çfarë të duan, por unë kurrë, kurrë nuk do t'ua thosha këtë lojtarëve të mi", ka shtuar Zidane. Real Madridi duhet ta fitojë fundjavën e ardhshme dhe Atletico Madridi duhet të humbasë në mënyrë që ta fitojë titullin e kampionatit.

## Portieri i Liverpoolit: Golin ia kushtoi babait të ndjerë

Portieri i Liverpoolit, Alisson, ia kushtoi babait të ndjerë fitoren e jashtëzakonshme në minutën e 95-të kundër West Bromit (2-1). "Unë jam shumë i emocionuar muajt e fundit për gjithçka që ka ndodhur me mua

dhe familjen time, por futbollit është jeta ime, kam luajtur që kur mund ta mbaj mend bashkë me babanë tim", ka thënë Alisson për "Sky Sports". "Do të doja që ai të ishte këtu për ta parë. Jam i sigurt që ai po feston me

Zotin në krah", ka shtuar ai. Alisson, gjithashtu, ka falënderuar të gjithë. "Unë kam qenë larg intervistave për një kohë të gjatë sepse gjithmonë jam emocionuar për atë temë, por dua t'i falënderoj të gjitha

mediat, të gjithë lojtarët dhe ekipet, kam pasur letra nga Everton, Manchester City, Chelsea dhe më shumë. Po të mos ishte për ju të gjithë nuk do ta kisha kaluar", ka deklaruar portieri brazilian.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Virtual Caffè” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuaj biznesin me numër të regjistrimit: 810830613 ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Virtual Caffè” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810830613, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Virtual Caffè” L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its nr. 810830613, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



**MATKOS GROUP**  
SHTERPCE HPP  
Shterpce, Kosove  
Tel: +377 44 900 900 Email: info@matkosgroup.com;

**NJOFTIM**

Shoqëria „Matkos Group“ Sh.p.k., me nr. Unik Identifikues 810810988 dhe të biznesit 70773538, me adresë: Rruga „Shpetim Robaj“ Nr. 289 – 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me kërkesën e saj të datës 23.02.2021 në përputhje me dispozitat ligjore të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në Burimet e Ripërtitshme të Energjisë, ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) kërkesën për MODIFIKIMIN e Autorizimit Final V\_760\_2016 të datës 28 janar 2016 për modifikimin/zvogëlimin e kapacitetit të turbinës nga 5.031 MW në 4.9 MW.

Arsyet e fillimit të Modifikimit të autorizimit final kanë të bëjnë vetëm me fuqinë instaluese të turbinave, ndërsa pjesa tjetër e projektit mbetet e pa ndryshuar e cila është konfirmuar përmes certifikatës së përdorimit nr. 06-351/02-13294/20 dt. 11.12.2020 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit të Komunës së Shtërpces.

Vërejtjet eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund të paraqiten në ZRRE brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “VALV” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuaj biznesin me numër të regjistrimit: 810806432 ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “VALV” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810806432, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “VALV” L.L.C. based in Prishtina, has come to the decision to quit its nr. 810806432, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Nebi Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Kabashit " Korishe.
- ▶ Azem Bytyqi shpall te pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Pashk Thaqi shpall te pavlefshme dëftesat shfmu " Zef Lush Marku " Velezh.
- ▶ Valon Salihu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275





Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

